



REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. Dep.	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.
2-0/DPK	01-4481/15
Nr. llog. Broj stranica Nr. pages	Data Datum Date
02	26.11.2015



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 25.11.2015, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-02-3432/15, për zyrtarin e lartë z. Bajram Kryeziu, Prokuror në Prokurorin e Shteti, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur konfliktin e mundshëm të interesit.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të interesit me numër protokolli AKK-03-02-3432/15, që për trajtim ka pasur zyrtarin e lartë z. Bajram Kryeziu, Prokuror në Prokurorin e Shtetit.

Gjatë zhvillimit të procedurës dhe analizimit të gjendjes është identifikuar se zyrtari i lartë, z. Bajram Kryeziu, Prokuror në Prokurorin e Shteti, gjatë kohës së ushtrimit të funksionit publik si zyrtar i lartë, ka të regjistruar dhe figuron si person i autorizuar në një biznes privat e që sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik Nr.04/L- 051, kjo situatë paraqet konflikt të interesit, dhe papajtueshmëri dhe kufizim në ushtrimin e funksionit publik, andaj Agjencia kundër Korrupsionit me datën 27.10.2015 e ka njoftuar zyrtarin e lartë me shkresën e parë se ka filluar procedura e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të Konfliktit të Interesit dhe se ka të drejtë në afatin prej 15 ditësh të njoftohet me faktet që posedon Agjencia.

Pas kësaj shkrese z. Bajram Kryeziu, ka ardhur në zyrat e Agjencisë kundër Korrupsionit ku nga zyrtaret e AKK-së, është njoftuar me faktet dhe situatën në të cilën gjendet.

z. Kryeziu, ne takim na ka njoftuar me gjerësisht me situatën, por është arsyetuar se asnjëherë pas emërimit ne funksionin publik të prokurorit nuk e ka ushtruar funksionin e Avokatit si dhe menjëherë pas emërimit ne funksionin publik ka njoftuar oden e Avokateve të Kosovës për emërimin e tij si prokuror, dhe ka filluar procedurat për shuarjen e biznesit me emër “Avokat Bajram Kryeziu”.

z. Kryeziu është zotuar se brenda afatit ligjore do të sjell dëshmitë për shuarjen e biznesit pasi që një kohe është në procedurën e mbylljes së këtij biznesi.

Me datën 23.11.2015, kemi pranuar dokumentin zyrtar nga z. Bajram Kryeziu, Prokuror ne Prokurorin e Shtetit ku dëshmohet nga dokumenti zyrtar i lëshuar nga ARBK-ja, se biznesi me nr. 70971046 emër “ Avokat Bajram Kryeziu”, është shuar ne mënyrë vullnetare, pra është mbyllur si biznes.

Vlerësojmë se pas veprimeve të ndërmarra nga z. Bajram Kryeziu, Prokuror në Prokurorin e Shtetit, duke bërë shuarjen vullnetare të biznesit, dhe pasi janë krijuar rrethana të reja konsiderojmë se është shmangur gjendjen e mundshme e konfliktit të interesit dhe papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit publik për zyrtarin e lartë z. Bajram Kryeziu, Prokuror ne Prokurorin e Shtetit, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja,

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari kontaktues)

Hasan Preteni
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

